



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1110 Prot.

Tiranë, më datë 21.07.2021

**VENDIM**  
**Nr. 435, datë 21.07.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, si dhe Vendimit Nr. 60, datë 29.01.2020 “Për deklarimin pasuri kulturore “Ansambël Historik Urban”, zonës mbrojtëse të tij dhe zonës arkeologjike “B”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 21.07.2021:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Njësi Akomodimi Hotel, 2-3 kate + podrum”, brenda kufirit të Zonës së Mbrojtur të Ansambilit Historik Urban të Voskopojës, me aplikues dhe projektues restaurator Aleko Papakozma, zhvillues Begator Mukallari;
2. Subjekti duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 60, datë 29.01.2020 “Për deklarimin Pasuri Kulturore “Ansambël Historik Urban”, Zonës Mbrojtëse të tij dhe Zonës Arkeologjike “B”, të fshatit Voskopojë dhe miratimin e Planit për Ruajtjen, Mbrojtjen dhe Administrimin e tyre”, Neni 11, Pika 4:
  - Zbatimi i punimeve të kryhet nga subjekte të licencuara për këtë kategori;
  - Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK Korçë;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
Arta DOLLANI

